



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i komunës së Rahovecit – Skupština opštine Oraovac

Kuvendi i komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas propozimit të Kryetarit të komunës, 01 nr. 67/2014 të dt. 04. 06. 2014, në çështjen administrative – shfuqizimit të Vendimit të Këshillit komunal të komunës së Rahovecit 01 nr. 211- 463 të dt. 16 .06. 1995, si dhe vendimet mbi dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore personave individual për ndërtimin e objekteve banesore në Rahovec dhe në fshatin Zoçisht, në bazë të nenit 12.2 pika d), dhe 17, pika s) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”) nr. 28/ 4 qershor 2008 nenit 93.4 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, (“Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nr. 8/ 1 janar 2007, dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 569/1 të dt. 16. 12. 2010, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen të mbajtur më 30 qershor 2014, merr këtë:

V E N D I M

I.- SHFUQIZOHET Vendimi i Këshillit komunal të komunës së Rahovecit 01 nr. 211 – 463 të dt. 16. 06. 1995, si dhe vendimet individuale për dhënien në shfrytëzim pa kompensim dhe pa të drejtë tjetërsimi të tokës ndërtimore në pronësinë shoqërore personave individual për ndërtimin e shtëpive familjare të banimit në fshatin Zoçisht dhe ato:

- Vendimi 01 nr. 151 – 464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/2, në sipërfaqe prej 0.02,51 ha, në emër të Kërstiq Spasa Velko;
- Vendimi 01 nr. 158-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/3 në sipërfaqe prej 0.03,31 ha, në emër të Llaboviq Radonja;
- Vendimi 01 nr. 152-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/4, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha në emër të Bllagojeviq Miodraga Boban;
- Vendimi 01 nr. 169-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/5, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Mishiq Zllatko;
- Vendimi 01 nr. 148-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/6, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Mishiq Bogolub;
- Vendimi 01 nr. 150-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/7, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Jovanoviq Jovana Milenko;
- Vendimi 01 nr. 154-464 të dt. 16 06. 1995, ngastra nr. 227/8, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Kërstiq Sretena Damjan;
- Vendimi 01 nr. 160-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 277/9, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Stankoviq Miodrag;
- Vendimi 01 nr. 162-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/10, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Stankoviq Nebojsa;
- Vendimi 01 nr. 156-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/11, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Simiq Dobrivoje;
- Vendimi 01 nr. 151-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/12, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Stojanoviq Ranko;

- Vendimi 01 nr. 157-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/13, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Mishiq Millovan dhe
- Vendimi 01 nr. 150-464 të dt. 16. 06. 1995, ngastra nr. 227/14, në sipërfaqe prej 0.02,51 ha, në emër të Simiq Petra Dejan, të gjithë nga fshati Zoqisht, sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 123 z.k. Zoqisht, PSH e Kosovës, KK Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.33,33 ha; z.k. Rahovec
- Vendimi 01 nr. 330-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1571/1 në sipërfaqe prej 0.03,63 ha, në emër të Matiq Nikolla Zhivko;
- Vendimi 01 nr. 370-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1571/5, në sipërfaqe prej 0.02,42 ha, në emër të Gërkoviq Nedelka Novica;
- Vendimi 01 nr. 377-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1566/5 në sipërfaqe prej 0.03,30 ha, në emër të Miciq Millorada Dejan;
- Vendimi 01 nr. 404-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1564/9 në sipërfaqe prej 0.02,52 ha, në emër të Simiq Radomira Sasha;
- Vendimi 01 nr. 338-464 të dt. 231. 07. 1996, ngastra nr. 1571/2 në sipërfaqe prej 0.02,69 ha, në emër të Shutakoviq Bllagoja Novica;
- Vendimi 01 nr. 404-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1571/3, në sipërfaqe prej 0.02,50 ha, në emër të Vitosheviq Tomislava Nenad;
- Vendimi 01 nr. 454-464 të dt. 31. 07. 1996, ngastra nr. 1571/8, në sipërfaqe prej 0.02,84 ha, në emër të Simiq Mlladena Dejan;
- Vendimi 01 nr. 336-464 të dt. 19.05.1995, pjesa e ngast.1566/1 në sipërfaqe prej 0.03,13 ha, në emër të Gërkoviq Llazara Stojan;
- Vendimi 01 nr. 425-464 të dt. 19. 05.1996 pjesa e ngast.1566/1 në sipërfaqe prej 0.03,13 ha, në emër të Dediq Millana Sasha;
- Vendimi 01 nr. 356-464 të dt. 19. 05. 1996, ngastra nr. 1567/4, në sipërfaqe prej 0.02,80 ha, në emër të Vitosheviq Lubomira Sinisha dhe
- Vendimi 01 nr. 42-464 të dt. 19. 05. 1995, ngastra nr. 1564/7, në sipërfaqe prej 0.02,56 ha, në emër të Bjelivuk Dragiq dhe Bilana, refugjatë nga Bosnja dhe Hercegovina, sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 613 z.k. Rahovec, PSH e Kosovës, KK Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.31,59 ha.

II.- Shpallja e Vendimit global 01 nr. 211-463 të dt. 16.06.1995 si dhe vendimeve individuale, të cekura më lartë, ka pasuar nga arsyet se personat në fjalë si shfrytëzuesit e tokës ndërtimore në pronësinë shoqërore, në afat prej 3 (tre) viteve, nga dita e dorëzimit të vendimit, nuk kanë ndërtuar objektet familjare të banimit e as që kanë kryer punët të konsiderueshme në ato objekte. Pasi që është vërtetuar se personat të përmendur në afatin e caktuar siç është paraparë në pikën III, të vendimeve individuale nuk kanë filluar me ndërtimin e objekteve familjare të banimit, me këtë humbin të drejtën e përparësisë së ndërtimit dhe i ndërpritet shfrytëzimi i mëtejme në ngastrat të përfituara ndërtimore në pronësinë shoqërore siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 24. al. 5. të Ligjit mbi tokën ndërtimore “Gazeta zyrtare e RSS”, nr. 23/90.

III.- Shpallja e Vendimit të Këshillit komunal të Komunës së Rahovecit, 01 nr. 211 – 463, të dt. 16. 06. 1995 si dhe vendimet të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, ndikojnë retroaktivisht nga momenti kur janë marr dhe me shfuqizimin e tyre anulohen të gjitha pasojat juridike që të njëjtat i kanë prodhuar (ex tunc).

A r s y e t i m

Këshilli komunal i komunës së Rahovecit, në bazë të nenit 23 të Ligjit mbi tokat ndërtimore “Gz e RSS nr. 23/92”, përveç tjerash personave individual i ka dhënë në shfrytëzim pa të drejtë tjetërsimi për ndërtimin e shtëpive familjare të banimit, ngastrat më afër të cekura në dispozitiv të këtij vendimi ndërsa nën pikën III të Vendimit të përmendur është obliguar secili përfitues i tokës ndërtimore në pronësinë shoqërore që në afat prej 3 (tre) viteve nga marrja e vendimit, të fillojë ndërtimin e objektit banesor.

Ky kuvend, nëpërmjet Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë, ka vërtetuar se në asnjë ngastër të cekur në dispozitiv të këtij vendimi nuk janë ndërtuar shtëpitë banesore, e që në bazë të nenit 20 al. 3, të Ligjit për tokat ndërtimore, parashihet se personat të cilët e fitojnë në shfrytëzim ngastrën ndërtimore në pronësinë shoqërore, janë të obliguar që në afat prej 3 (tre) viteve, nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, të ndërtojnë ndërtesën, respektivisht të kryejnë punët e konsiderueshme në at objekt (vuarja e ndërtesës nën pullaz, ose kryerja e pjesës më të madhe të punëve ndërtimore të objektit). Personi i cili në afatin e caktuar sipas al. 3, nenit 23 të këtij ligji, nuk ndërton objektin banesor ose nuk i kryen punimet të konsiderueshme në atë objekt, humbë të drejtën e përparësisë së ndërtimit nën kushtet dhe mënyrën e caktuar me vendim të Kuvendit të komunës.

Gjithashtu edhe Kryetari i komunës me aktin 01 nr. 67/2014 të dt. 04. 06. 2014, i ka propozuar këtij Kuvendi miratimin paraprak të Vendimit për shfuqizimin e Vendimit global të Këshillit komunal të komunës së Rahovecit 01 nr. 211 – 463 të dt. 16. 06. 1995 dhe Vendimeve individuale të cekura më lartë lidhur me ri – kthimin e paluajtshmërisë, pasi që personat të përmendur më lartë, që kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit në atë paluajtshmëri në afat të caktuar ligjor nuk kanë ndërtuar objektet banesore.

Meqenëse sipas dispozitave të nenit 93.4 të Ligjit për procedurën administrativen nr. 02/L-28, nuk është paraparë kurrfarë afati ligjor për ndryshimin, shfuqizimin apo shpalljes së pavlefshme të akteve administrative të formës së prerë, e që kjo varet nga rrethanat konkrete, ai vendim mund të shfuqizohet në “çdo kohë” sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës së interesuar, pa marrë parasysh në kalimin e kohës.

Nga arsyet të cekur më lartë është vendosur si në dispozitiv të vendimit.

KËSHTILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk mund të parashtrohet ankesë, por me padi mund të zhvillohet konflikti administrativ pranë Gjykatës Themelore – Departamenti për konfliktet administrative në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 69/2014

Rahovec, 27.06. 2014

**Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani**